



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KESHILLI PAVARUR MBIKEQYRES PER SHERBIMIN CIVIL TE KOSOVES
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUZBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERV. OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Punelena/Prodato Received/Delivered	15.04.2021	vit god year	
Organ /Ijesta Organ /Jedinitca Org./Unit	Dr. Prof. Dr. Prof. Prof. No.	Shtetes Prilesq. Appointe	Sasia Kufizesa Quantity
SKIMSHIK	18/11/2021		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A.nr.170/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë, si dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, duke u bazuar në Aktgjykimin A.nr.3009/19 të datës 12.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.638/2019 të datës 18.03.2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë në Rr. "Agron Berisha", pa numër në Komunë të Suharekës, kundër organit të punësimit Ministrisë së Infrastrukturës, në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 15.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa A.nr.638/2019 e datës 18.10.2019 e parashtruar nga ankuesi

II. MBETET në fuqi Vendimi me numër protokolli 01/10441 i datës 24.09.2019, i Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës, i korrigjuar me Vendimin me numër protokolli 01/10478 të datës 25.09.2019 dhe Akt emërimi i datës 20.07.2012 të ankuesit i punësuar në pozitë: *Zyrtar për zhvillimin e programit të patentë shoferit, në Departamentin e Automjeteve -Njësia e Patentë Shoferit në Prizren.*

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në vendin e punës: *'Zyrtar për zhvillimin e programit të patentë shoferit'*, në Ministrinë e Infrastrukturës sipas Akt emërimit të datës 20.07.2012, në Departamentin e Automjeteve, Njësia e Patentë Shoferit në Prizren.

Me datë 03.05.2019 Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës, ka nxjerrë Vendimin Nr.01/4707 me të cilin e ka transferuar ankuesin me transferim të përhershëm në pozitë *"Udhëheqës i Njesisë së Patentë Shoferëve në Prizren"*, në kuadër të Departamentit të Patentë

Shoferëve në Ministrinë e Infrastrukturës, kurse me Vendimin e datës 02.08.2019 e transferon përkohësisht nga pozita "Udhëheqës i Njesisë së Patentë Shoferëve në Prizren", në pozitë "Udhëheqës i Njesisë së Patentë Shoferëve në Gjakovë" dhe me Vendimin e datës 18.09.2019, nga pozita "Udhëheqës i Njesisë së Patentë Shofereve në Gjakovë", e transferon në pozitë "Udhëheqës i Njesisë së Patentë Shofereve në Prizren".

Me datë 24.09.2019, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrinë e Infrastrukturës, ka nxjerrë Vendimin me numër 01/10441 me të cilin ka shfuqizuar Vendimin nr.01.4707 të datës 03.05.2019 dhe Vendimin nr.01.10247 të datës 18.09.2019, i cili vendim është korrigjuar me datë 25.09.2019 në pikën I, me Vendimin me numër protokoll 01/10478, duke shfuqizuar Ndryshim dhe Plotësimin e Akt emërimit, të datës 11.06.2019.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin nr. 01/10441 të datës 24.09.2019, me datë 18.10.2019 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me numër protokoll 4927/2019, me pretendime ankimore kundër kthimit në vendin e punës, sipas Akt emërimit të datës 20.07.2012.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, më datën 23.10.2019 kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses e ka proceduar në Ministrinë e Infrastrukturës. Me datë 01.11.2019 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Ministria e Infrastrukturës, me shkresat e bashkëngjitura të lëndës (faqe 1-12).

Kolegji për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova: Aktgjykimi 3009/2021 i datës 12.03.2021, i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, i pranuar në Këshill me datë 18.03.2021; Ankesa me numër A.nr.639/2019 e datës 18.10.2019 me numër protokoll 4927/2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil; Njoftimi i datës 25.11.2019; E-maili i datës 20.11.2019; Përgjigje e datës 01.11.2019; Vendimi i datës 25.09.2019 nr.01/10478; Vendimi i datës 24.09.2019 nr.01/10441; Vendimi me Nr.protokoll 01.8447 i datës 02.08.2019; Vendimi Ndryshim dhe Plotësimi i Akt emërimit i datës 11.06.2019; Akt emërimi i datës 20.07.2012; Prova shtesë e datës 01.04.2021; Vendimi me numër protokoll 01/10247 i datës 18.09.2019; Vendimi nr. protokoll 01/4707 i datës 03.05.2019.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët ka konstatuar që ankesa e ankuesit është e pazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili atakon shfuqizimin e Vendimit Nr.01/4707 të datës 03.05.2019 dhe Vendimin Nr.01/10247 të datës 18.09.2019 i nxjerrë nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës, lidhur me transferimin e ankuesit për ushtrimin e detyrës "Udhëheqës i Njesisë së Patentë Shofereve në Prizren", si dhe kundër kthimit në vendin e punës, sipas Akt emërimit të datës 20.07.2012, të cilat vendime janë shfuqizuar sipas Vendimit të datës 24.09.2019 i cili vendim është korrigjuar me datë 25.09.2019 në pikën I, me Vendimin me numër protokoll 01/10478, duke shfuqizuar Ndryshim dhe Plotësimin e Akt emërimit, të datës 11.06.2019.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se ankuesi kundër Vendimit me numër 01/10441 të datë 24.09.2019 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së

Infrastrukturës, me datë 18.10.2019 ka parashtruar ankesë brenda afatit ligjor në Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës Për Shërbimin Civil të Kosovës, në pajtim me nenin 24 paragrafin 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se ankuesi sipas Akte emërimit të datës 20.07.2012, ka themeluar marrëdhënieje të punës të karrierës, në Ministrinë e Infrastrukturës në pozitë *"Zyrtar për Zhvillimin e Programit të Patentë Shoferit"*, në Departamentin e Automjeteve Njësia e Patentë Shoferit në Prizren, sipas Akte emërimit të datës 20.07.2012, të cilit i është bërë transferimi i përhershëm me Vendimin me numër 01/4707 të datës 03.05.2019 në pozitë *"Udhëheqës i Njesisë së Patentë Shofereve në Prizren"*, në kuadër të Departamentit të Patentë Shoferëve në Ministrinë e Infrastrukturës, i nxjerrë nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës, në kundërshtim me nenin 28, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: *1. "Transferimi i Nëpunësve Civil mund të bëhet në formë të ricaktimit në vend tjetër të punës dhe si transferim i përkohshëm në detyra tjera. 2. Nëpunësit civilë mund të caktohen, si masë jo disiplinore, në mënyrë të përkohshme ose të përhershme në vende të tjera pune për ushtrimin e funksioneve të njëjta ose të ndryshme, në të njëjtën kategori funksionale dhe gradë"*, si dhe në kundërshtim me nenin 8 paragrafi 4 i Rregullores Nr. 06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civil i cili përcakton se; *"Transferimi bëhet në pajtim me eprorin e drejtpërdrejtë të tij, dhe me miratimin e udhëheqësit më të lartë administrativ të institucionit, si dhe me pëlqimin e nëpunësit civil"*, që në rastin konkret në provat e lëndës nuk ka dëshmi të ofruara as nga ankuesi dhe as nga organi i punësimit, lidhur me zbatimin e kësaj dispozite dhe as pëlqimin e ankuesit për transferim të përhershëm.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka analizuar provat e lëndës dhe pretendimet e ankuesit ka konstatuar se Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Infrastrukturës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër 01/4707 të datës 03.05.2019 për transferimin e përhershëm të ankuesit nga pozita *"Zyrtar për Zhvillimin e Programit të Patentë Shoferit"*, në Departamentin e Automjeteve, në pozitë *"Udhëheqës i Njesisë së Patentë Shofereve në Prizren"*, në Departamentin e Patentë Shoferëve, në Ministrinë e Infrastrukturës, ka vepruar në kundërshtim me nenin 27 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, 1.2 dhe nën paragrafin 1.3 të Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: *"1. Avancimi nga një pozitë më e ulët në pozitë më të lartë funksionale ose nga një gradë më e ulët në një gradë më të lartë brenda pozitës funksionale lejohet në bazë të: 1.1. disponueshmërisë së pozitave të lira; 1.2. plotësimit të të gjitha kushteve të caktuara për atë pozitë; 1.3. kalimit të kohës së caktuar minimale; dhe 1.4. kalimit me sukses të testimit, dëshimit të meritës, aftësive dhe kompetencës profesionale"*, dhe në kundërshtim me parimet themelore për avancim në karrierë në shërbimin civil i cili bëhet në mënyrë transparente, të drejtë, të unifikuar, objektive dhe në bazë të meritës së kandidatëve përkatës siç e përcakton në nenin 3 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Rregullores Nr.21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civilë, sepse ngritja në detyrë apo avancimi nga një pozitë më e ulët në pozitë më të lartë funksionale në shërbimin civil, duhet të zbatohen dispozitat e lartë cekura, për avancim në karrierë, e jo siç është vepruar me transferim të përhershëm, në kundërshtim me procedurat e avancimit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka analizuar pretendimet ankimore të ankuesit dhe bazuar në provat e lëndës ka konstatuar se, në raste të zhvillimit të procedurave të transferimit të përhershëm në Institucionin e njëjta në shërbimin civil, duhet të veprohet

në pajtim me 8 paragrafi 1,2, 3 dhe 4 të Rregullores Nr.06/2010, për Transferimin e Nëpunëseve Civil, ku thuhet se: "1.Nëpunësit civil mund të transferohet në mënyre të përhershëm në vende tjetër punë, për ushtrimin e funksioneve të njëjta ose të ndryshme në të njëjtën kategori funksionale gradë dhe hap të pagës, brenda institucionit në shërbimin Civil. "2 transferimi i nëpunësit civil në vende tjetër të punës, me detyra dhe përgjegjësi tjera duhet të jetë në përputhje me përgatitjet profesionale të tij, dhe nuk duhet të ndikojë në zhvillimin e karrierës së nëpunësit civil. "3 nëpunësi civil mund ta refuzojë transferimin e përhershëm në qoftë së ai konsideron se vendi i tjetër i punës i ofruar është i papërshtatshëm, refuzimi duhet te arsyetohet. "4.Transferimi behët në pajtim me eprorin e drejtpërdrejtë të tij, dhe me miratimin e udhëheqësit më të lartë të institucionit, si dhe me pëlqimin e nëpunësit civil",

Bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 3.6 të Ligjit Nr.06/1-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrinë e Infrastrukturës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër 01/4707 të datës 03.05.2019, me asnjë dëshmi nuk ka arsyetuar nxjerrjen këtij vendimi si dhe Ndryshim plotësimi të Akt emërimit të datës 11.06.2019, ku dhe është bazuar në dispozitat ligjore të nenit 10 paragrafin 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.3, si dhe paragrafi 3 të Rregullores Nr.06/2010, për Transferimin e Nëpunëseve Civil, mbi këtë bazë është konstatuar se Sekretari i Përgjithshëm i Ministrinë e Infrastrukturës, në rastin konkret ka dështuar në veprimet administrative, duke mos argumentuar gjendjen faktike dhe bazën juridike. Po ashtu edhe me rastin e nxjerrës së Vendimit me Nr.01/8447 të datës 02.08.2019, me të cilin ka transferuar ankuesin në pozitë "Udhëheqës i Njesisë së Patentë Shofereve në Gjakovë".

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se me datë 11.09.2019 Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, ka hy në fuqi dhe i cili ka qenë i zbatueshëm deri me datë 19.11.2019, mbi këtë bazë Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës, ka nxjerrë Vendimin Nr.01/10247 të datës 18.09.2019 me të cilin i ka bërë transferimin e përkohshëm ankuesit nga pozita "Udhëheqës i Njesisë së Patentë Shoferëve në Gjakovë" në pozitë "Udhëheqës i Njesisë së Patentë Shofereve në Prizren" ndërsa kolegji konstaton se ky vendimi mbi transferin është bërë në kundërshtim me dispozitat e ligjit të zyrtarëve publik që ka qenë në fuqi më datë 18/09/2019.

Andaj, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës, me datë 24.09.2019 ka nxjerrë Vendimin me numër 01/10441, me të cilin ka shfuqizuar Vendimin Nr.01/4707 të datës 03.05.2019 dhe Vendimin Nr.01/10247 të datës 18.09.2019, për ankuesin i transferuar në pozitë "Udhëheqës i Njesisë së Patentë Shofereve në Prizren", në Departamentin e Patentë Shoferëve, në Ministrinë e Infrastrukturës, ka vendosur në pajtim me nenin 53 të Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në pajtim me përgjegjësit e tij të bazuara në nenin 18 të Ligjit Nr.06/1-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, në pajtim me nenin 39 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, i cili vendim është korrigjuar me datë 25.09.2019 me Vendimin me numër protokolli 01/10478, ka shfuqizuar dhe Ndryshim Plotësimin e Akt emërimit të datës 11.06.2019, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitave të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.170/2021, datë 15.04.2021.

Zyle Millaku-GOJNOVCI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Infrastrukturës,
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Infrastrukturës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

